Vatikani konsideron si të papëlqyeshme hapjen e xhamive në aeroportet evropiane. Sipas tyre, më mirë do të ishte të ekzistojnë hapësira ndërfaqësore, deklaroi të martën kryetari i këshillit të papës për kulturë dhe marrëdhënie ndërfaqësore kardinali Poupard. "Është më rëndësi që kapelat (kishëzat) krishtere në aeroporte ta përmbajnë karakterin e tyre krishterë", tha Paul Poupard, duke shtuar se "në vendet me traditë krishtere në vend të sallave për kryerjen e riteve islame apo xhamive në aeroporte, më mirë do të ishte të kemi hapësira për rite ndërfaqësore."

Atë hapësirë nuk do ta shfrytëzonin vetëm pjesëtarët e një besimi por të gjithë. Natyrisht krishterët edhe më tej do të kishin kapelat e tyre.

Për këtë, Kardinali Paul Poupard, foli në seminarin e XIII ndërkombëtar të kapelanëve krishterë i cili mbahet në Romë. Poupard tha se dialogu ndërfaqësor është i nevojshëm për luftën kundër terrorizmit.

"Dialogu ndërfaqësor është armë e bardhë kundër terrorizmit", tha Poupard dhe shtoi se respektimi i ligjit natyror është "bazë për dialog mes besimtarëve të besimeve të ndryshme si dhe mes besimtarëve dhe atyre që nuk besojnë."

Poupard theksoi se çdo iniciativë për dialog ndërfaqësor zvogëlon tensionet, hapë mundësinë për zgjidhjen e problemeve dhe çka është kryesore hapë rrugën drejt paqes.

<http://islamgjakova.net>



Forcat amerikane vrasin 7 nxënës të një shkolle në Irak

Të paktën 7 nxënës irakianë kanë humbur jetën si pasojë e një sulmi të helikopterëve të ushtrisë amerikane ndaj një shkolle në veri-lindje të Bagdadit.

Sipas burimeve të informacionit, gjatë këtij sulmi gjithashtu janë plagosur tre nxënës irakianë.

Sipas të dhënave të institutit amerikan "Brookings", që nga pushtimi i Irakut në mars të vitit 2003 e deri më tani, në këtë vend janë vrarë 750 mijë qytetarë irakiane. Kurse revista e njohur angleze "Lanset" kohë më parë njoftoi se gjatë kësaj periudhe në Irak janë vrarë 650 mijë qytetarë irakianë

<http://mesazhi.com>

Kur'ani, burimi i mjekësisë moderne

Kur'ani famëlartë bëhet mjet i shërimit në mjekësinë moderne. Dijetarët e Kur'anit dhe doktorët e mjekësisë themelojnë një institut.

Javën e kaluar në Emiratet e Bashkuara të Arabisë është mbajtur një konferencë shkencore ku është marrë vendimi që Kur'ani famëlartë të jetë si vegël për shërimin e sëmundjeve në mjekësinë moderne.

Në konferencën "Shërimi me Kur'an ndërmjet fesë dhe mjekësisë" është nxjerr përfundimi që të themelohet një institut nga ana e dijetarëve të Kur'anit dhe doktorëve të mjekësisë.

Instituti në fjalë krahas përqendrimit në citatet Kur'anore për shërim do të bashkëpunojë edhe me spitalet zyrtare të drejtimeve të ndryshme të mjekësisë.

Në konferencë kanë marrë pjesë specialistët e ndryshëm të universiteteve botërore ku nga ta është marrë vendimi që të vazhdojnë punimet shkencore për shërimin e sëmundjeve me Kur'an.

<http://islamgjakova.net>



Vitet e fundit mbi 40.000 belgë konvertohen në fenë Islame

Kështu titullohet artikulli në gazetën belge "Lose war", duke vazhduar se Briseli është qytet me përqindjen më të madhe të popullatës e cila vitet e fundit janë konvertuar në islam, në krahasim me qytetet tjera Evropiane.

Gazeta më tej thekson, se numri i shtetasve belg është 10 milion, prej të cilëve 450.000 janë mysliman, çka do të thotë nëse me këtë tempo belgët vazhdojnë ta pranojnë islamin, në vitin 2012 ky numër shume lehtë mund të ngritet në gjysmë milion.

Sipas kësaj gazete shkaku kryesor i animet kah feja islame është se në islam mes Zotit dhe njeriut nuk ka ndërmjetësues, dhe pastërtia e jetës morale gjë për të cilën vuan bota perëndimore dhe Evropiane.

Për shkak të numrit mjaft të madh të belgëve të konvertuar, e djathta radikale përmes medimeve të ndryshme filloi fushatë të ashpër kundër islamit, duke sulmuar normat dhe vlerat islame.

Por, në anën tjetër qeveria belge u ka ofruar bashkëpunim të papritur të gjithë belgëve të konvertuar në islam, duke u ofruar leje zyrtare për formimin e kolegjiut të vakëfeve islame, në krye të cilët do të jetë Jasin Bejan, i cili para disa viteve përqafoi islamin.

<http://islamgjakova.net>

MUSLIMANET SHQIPTAR PENALIZOHEN NGA PESHKOPI JANULLATOS

Me nje titull shume provokues se Shqiperia nuk eshte vend tipik musliman. gazeta shekulli e dates 18 maj 2007. zinte faqen kryesore te saj me nje interviste te peshkopit grek. qe ka uzurpuar kishen ortodokse shqiptare. dhene stacionit thellesisht antimusliman Dojce Vele. ku ai hedh ide dhe jep mendime te cilat nje njeri normal i merr si te paverteta. Por. duket se zoterise nuk i interesojne shume ato qe e lexojne dhe e ndigjojne. por i intereson ato qe ai kerkon te percjelle ne publikun mediatik Duke u perpjekur te fshehe ardhjen e tij ne Shqiperi. e cila u mbeshtet nga nje prapavije e fuqishme greke. ai ben te pamunderen te arsyejoje qendrimin e metejshem ne Shqiperi. duke deklaruar permes intervistes se ate e paskan thirrur shqiptaret ortodokse. sikur ne Shqiperi te kishte nje qeveri ortodokse. ku kisha ortodokse e shtron dhe e servir dreken vete. duke harruar me qellim te tregojne se ate e kane sjelle dhe e kane mbajtur muslimane te tille si; Ramis Alia dhe Sali Berisha te cilet drejtonin dhe drejtojne politiken shqiptare. Ne intervisten e tij. peshkopi grek. i nxerr shpejt kthetrat e tij kunder muslimaneve duke. u kujtuar politkaneve muslimane dhe me gjere se ato nuk kane te drejte te

merren me punet e tij dhe te kishes greke. sikur kjo kishë te nonte ne ajer dhe jo ne token shqiptare. ku pergjegjesia eshte e te gjithë shqiptare te cilet duhet te percjellin te gjitha ngjarjet dh aktivitetet qe behen ne atdheun e tyre. Nje pjese e konsiderueshme e kesaj interviste kishte ne qender perpjekjet qe bente Janullatosi per te krijuar bindjen se ate e donin ne Shqiperi jo vetem ortodoksit. por te gjithë shqiptaret duke. na kujtuar deshtimin e kushtetutes se vitit 1994 qe parashikonte largimin e peshkopit grek nga Shqiperia duke harruar te pranoje se ato ishin votime politike dhe pak kujt i bente ne mend ne ato vite per peshkopin grek. qe po ngulte. pas shpines se shqiptarve. piketat per qendrim te perhershëm ne Shqiperi. Peshkopi. nese do te testeje sa e duan ortodoksit dhe te gjithë shqiptaret le te kerkoje nje referendum per qendrimin e tij ne Shqiperi. Si paradhenje po i kujtojme ndeshjen Shqiperi- Greqi. ku u manifestua publikisht 'Dashuria e madhe' e shqiptarve per greket dhe Greqine. Jemi te sigurte se peshkopi grek nuk do te kishte nevojë per nje test tjetër dashurie nga shqiptaret. i pyetur per priflerin greke. qe kane mbushur kishat ortodokse. ku primadone eshte ai vete. peshkopi sulmon KMSH duke deklaruar se aty ka me mijra arabe. nje genjeshter qe as ai se beson. sepse. po te kishte se paku nje hoxhe arab jemi te bindur se ne cast do te ishte rritur numuri i gazetave ne Shqiperi dhe ato ekzistuset do te kishin tashme nje tirazh record. duke treguar se terroristet zbarkuan ne Shqiperi dhe per pasoje do te kishin nj rast te mire t. u. benin muslimaneve shqiptare nje Nate te Shen

Bartolmeut. E verteta eshte se po behen dy ekada dhe Kisha Ortodokse Shqiptare nuk po pergadit nje prif shqiptar. qe te kaloje ne pension peshkopin grek. e cila. me kete paaftes te saj. na bind se ajo eshte vasale e kishes greke qe. per te vepruar ne dem te interesave te ortodokse shqiptar. ka instaluar ne maje te saj peshkopin grek. qe thuhet se nuk ben vetem punet e fese ne Shqiperi. por mund te jete angazhuar ne ate qe ne po e quajme shume punesim e qe i siguroi edhe



titullin qytetare nderi i Tiranës. te cilin. per garniture. Edi Rama ua dha edhe drejtuesve katolike dhe muslimane Per Janullatosin. shqiptaret duhet ta falenderojne peshkopin grek se ai ka bere sacrifice te madhe per te punuar per Shqiperine Per kete. ai na kujton Terezen e Kalkutes. qe paska lene Ballkanin e bukur per te shkuar ne Indi qe te ndihmoje te varfrit. dhe ai per analogji paska lene rehatine personale dhe Greqine e bukur per te ndihmuar dhe shpetuar shqiptaret duke pohuar pa dashje se edhe ai eshte nje misionar i religjionit te tij fetar si eshte edhe Tereza e Kalkutes. nje misionaree religjionit te cilit i takon. Peshkopi grek tashti eshte bere edhe nje figure e rrezikshme ne jeten politike te Shqiperise. sepse deshron dhe planifikon qe. ne udheheqjen e vendit. te vije nje brez i ri politikanesh te tipit Kokedhima. qe vendosin dhe rrezojne kryeministrat shqiptare. sipas prapavijes qe i mbeshtet. duke na bindur se politka shqiptare sot eshte e nje vasaliteti te kalbrit te rende. kunder te ciles militojne figura te rrezikshme si peshkopi Janullatos. Duke e hequr vehten si Zeusi ne njohjen e religjoneve fetare ne Shqiperi ai. deklaroi ne intervisten e tij se Shqiperia nuk eshte nje komb tipik musliman. por eshte nje shtet multietnik. duke harruar se shteti shqiptar eshte shteti i vetem homogjen ne Ballkan. ku minoritetet jane dukuri mikroskopike. por qe politka greke. me peshkopin grek ne SHqiperi sajojne shifra fiktive per keto minoritete. Vete Greqia. zoteri peshkop. eshte modeli i nje shteti multietnik. ku minoritetet nuk njihen dhe nuk respektohen Per ne eshte e paqarte perse peshkopi nuk eshte i

bindur se kombi shqiptar. me shumice popullsi muslimane nuk eshte komb musliman shumuce Ai. duhet te lexoje akademikun Rexhep Qosja per te njohur te verteten e identitetit te muslimaneve shqiptar. Janullatosi. deklaroi se identiteti i shqiptarve nuk duhet te jete i ndryshem nga ai i fqinjëve. sepse SHqiperia nuk eshte Arabi. por eshte Ballkan. Shume rralle jane ndegjuar thirrje kaq te hapura drejtuar muslimaneve per t. u konvertuar ne te krishtere

Janullatosi dhe te tjere qe jane ne krah te tij. ose pas tij u ntereson te kultivojne percarje tek muslimanet shqiptare. duke i ndare ne muslimane arabe dhe evropjane. duke harruar se muslimanet ne Shqiperi. si ne te gjithë boten. kane te njejtin profet dhe te njejtin Kuran dhe si rrjellore ato nuk mund te parcelizohen Thirrja per te konvertuar. muslimanet ne te krishtere nga peshkopi grek. ne intervisten dhene Dojce Vele. eshte misioni kryesor i ketij peshkopi te huaj. misionon qe pa tjetër ia kane ngarkuar qendra n d e r k o m b e t a r e antiislame. qe jane me lart se Janullatos igrek. i pyetur per perqindjet fetare ne Shqiperi ai do

te perifrazoje nje thenie te Enver Hoxhes ne nje komunikim me Stalinin. te cilit i rraportonte se ka 30 perqind ortodoks ne Shqiperi. ne nje kohe qe udheheqesi shqiptar i atyre viteve me kete shifer u referohej te kishtereve ku perfshihen edhe katoliket

Me nje strategji te re. qe shpalos ne kete interviste. peshkopi grek sulmon tolerancen fetare. si nje dukuri qe tashme e quan te kapercuer dhe arrogante duke hedhur mbi tavoline nje karte te re. qe eshte bashkepunimi ne mes te reigjoneve fetare. qe te hyje keshtu ujku ne vathe te muslimaneve dhe kur te dalin nga vatha te kene mbetur muslimane ne vathe sa te numurohen me gishta i trimuar. nga se ndien se eshte i fuqishem per te mashtruar. peshkopi grek betohet s ky bashkepunim ka shpetuar Bosnjen nga genocidi duke harruar te flase per pjesemarrjen direkt te kishes ortodokse serbe ne krimet kunder muslimaneve dhe prezencen fizike te priflerinje ortodokse ne pushkatimet e civileve boshnjake. Boshnjaket e mjere nuk i shpetoi nga genocidi as toleranca ekstreme fetare. as bashkepunimi fetar. por e pane vehten ne te huna e thikes se kishes ortodokse serbe qe eshte simoter e kishes ortodokse greke. ku ka koken edhe Janullatosi. Opsioni i vetem per muslimanet eshte qe mos te bien ne kurthen e peshkopit grek dhe te atyre qe jane pas tij dhe te jene te bashkuar. qe te deshtojne planet e ketij oeshkopi te huaj qe kembet i ka ne Shqiperi dhe koken e ka ne GREQI

Selim Gokaj Shkoder. me 20.5. 2007

INTERVISTE ME IMAMIN E XHAMISE SE TABAKEVE Z. ELVIS NACI

Z. Elvis. Keto dite ju se bashku me xhematin e xhamise se Tabakeve, ku edhe jeni imam i saj keni hyre ne nje greve urie ne shenje proteste per shitjen e pronave te vakufit qe po ben KMSH. Menduam te bejme kete interviste me ju per te sqaruar vete ju motimet e ketij veprimi kaq te ashper protestues ndaj KMSH.



Pyetje: Cili eshte qellimi qe ju dhe xhemati i xhamise ku ju jeni imam vendoset qe te hyni ne greve urie?

Pergjigje: Se pari me lejoni qe te falenderojme gazeten e pavarur "Besimtari" e cila e quajti te drejte te trajtonte problemin e greves se urise se xhematit te xhamise se Tabakeve dhe me kete rast i urojme suksese ne misionin e saj ne dobi te trajtimit te problemeve islame ne Shqiperi dhe me gjere e cila duke qene e pavarur ka mundesi te pakufizuar per ta paraqitur kete realitet. Ne lidhje me pyetjen tuaj une po ju them se ka dy arsye perse ne kemi bere nje veprim te tille.

Se pari eshte e ndaluafetarisht qe nje prone e Vakufit te shitet aq me teper nga KMSH i cili

eshte i obliguar qe te ruaj dhe te mos tjetersoje keto prona

Se dyti ne me kete akt denoncojme ne menyre publike menyren si u realizua kjo shitje sepse cmimet jane qesharake ne krahasim me ato te tregut dhe na bene te dyshojme per veprime jo te ndershme nga ato qe jane angazhuar direkt ne kete akt-shitjeje.

Pyetje: A keni mbeshtetje nga xhematet e xhamive te tjera te Tiranës apo greva e juaj eshte e lokalizuar vetem ne xhamine e Tabakeve?

Pergjigje: Pyetja juaj eshte shume e drejte por une po ju them ju se permes peticioneve qe jane marre ne xhamite e Tiranës mbeshtetesit e kesaj greve jane me mijera per arsyen e thjeshte se pronat jane te te gjitha muslimane.

Pyetje: Mendojme qe te marrim opinionin tuaj ne se keni mbeshtetje edhe nga qytetaret e tjere te Tiranës qe nuk jane pjese e xhematit te xhamive

Pergjigje: Ju ndoshta edhe mund te habiteni por nje mbeshtetje e tille eshte reale sepse tashme opinioni i gjere publik eshte tashme i njohur me veprimet e dyshimta qe jane bere nga ky institucion qe duhet te jete ne fakt shembull ndeshmerie dhe korrektese ne veprime te tilla.

Pyetje: Sa eshte shkalla e sigurise tek greva e urise dhe tek grevistet per te fituar betejën me KMSH per problemin e pronave te vakufit?

Pergjigje: Rendesit ka qe besimtaret te jene te gatshem te bejne sakrifica per te mbrojtur pronat e vakufit dhe ato ne keto qendrimet duhet te mbeshteten tek Allahu, sepse suksesi dhe humbja jane ne doren e TIJ dhe varen prej TIJ.

Pyetje: Kush e ka pjesen e luanit ne KMSH per kete veprim antiislam dhe antistatuor?

Pergjigje: Mendojme se pergjegjesia me e madhe bie mbi ato qe e kane firmosur kete aktshtetje dhe ne vecanti tek ato qe drejtojne ne KMSH zyren qe merret me administrimin e pronave te vakufit, zyres ekonomike dhe ne vecanti myftiu i Tiranës nje njeri i paafte dhe antistatuor sic eshte Shaban Saliu.

Pyetje: A do te ishte e nevojshme qe ne KMSH te behej nje reforme qe tu thuhej ndal ketyre veprimeve abuzive dhe nje fryme e vertete

islame te karakterizonte KMSH?

Pergjigje: Ngjarjet e fundit dhe shume ngjarje dhe veprime te tjera te KMSH-se e kane zbehur shume imazhin e ketij institucioni qe perfaqeson shumicen e popullsisë shqiptare duke i bere dem kesaj shumice dhe duke i demtuar rende imazhin esaj. Prandaj eshte me shume se e nevojshme nje reforme ne KMSH qe te marrin fund veprime dhe praktika te tilla qe demtojne interesat e muslimaneve ne Shqiperi.

Pyetje: Cila eshte arsyeja qe KMSH po luan sot rolin e grevethesit duke demtuar imazhin e tij dhe interesat e muslimaneve shqiptar?

Pergjigje: Duket se ne KMSH statutin e sjellin si flugun nga te fryje era e interesave personale ose e interesave te klaneve te caktuara te cilat jane ne nje piste diametralisht te kundert me interesat e muslimaneve. Duke i trajtuar rastet si te vecanta KMSH vete flet dhe vete vulos.

Pyetje: A keni nje afat kohor kur do ta qyani te mbyllur greven qe po vazhdoni?

Pergjigje: Ne mendojme qe greva do te nderpritet kur ne te kemi arritur te realizojme qellimin tone qe eshte anulimi i kontrates per shitjen e truallit prane monumentit te Azem Hajdarit dhe deri ate dite ne do te shfrytezojme edhe hapësira te tjera demokratike si grevat lokale ne Tirane dhe greva kombetare duke sensibilizuar besmtaret muslimane ne te gjithë Shqiperine.

Z. Elvis ne ju falenderojme shume per intervisten dhe per urimin qe na bete per fillimin e botimit te gazetes "Besimtari" dhe ne nga ana tjetere urojme qe problemi per te cilin ju keni hyre ne greve urie te marre zgjidhje mbrenda parametrave te fese islame dhe te interesave te muslimaneve.

Ju faleminderit!

Z. Elvis Naci: Ne emrin tim personal dhe ne emrin e xhematit te xhamise se Tabakeve ju falenderojme ju dhe gazeten "Besimtari" per angazhimin tuaj per problemet qe kane lidhje me interesat e fese islame dhe te besimtarve muslimane ne Shqiperi dhe me gjere. Ju faleminderit!

DEKLARATE

SHOQATA BAMIRESE SHKODER, SHOQATA E INTELEKTUALENE SHQIPTAR KULTURA ISLAME DEGA SHKODER, FORUMI MUSLIMAN SHQIPTAR DEGA SHKODER DHE KLUBI KULTUROR DRITA...

...Kane percjellur dhe vazhdojne te percjellin me shume shqetesim menyren si KMSHpo administron pronat e vakufit te cilet kane rendesi jetike per te gjithë muslimanet ne SHQIPERI. Me keqardhje ne kemi konstatuar nje paaftesi dhe nje perkushtim deficitar ne punen qe kane kryer drejtuesit e zyres se vakufit prane KMSHdhe veprime te rrezikshme nga persona mrenda ketij komiteti te cilet kane te drejten e vendim marrjes. Klane dhe persona te vecante kane bere vazhdimisht perpjekje per te interpretuar statusin e KMSH per te krijuar hapësira qe do t, u krijonte mundesi qe ato te vepronin me pronat e vakufit, sikur te ishin prona qe ua kishte lene dikush atyre si trashigim Duke vepruar ne kete menyre, ato bene presion mbi myftinit e rretheve qe edhe ato te tjetersoje pronat e vakufit ne te njejten linje me KMSH duke rrezatuar keshtu shume rrezikshem nje veprim qe asfikson perfundimisht aktivitetin fetar musliman ne Shqiperi. Aty, ku KMSHperballoi rezistence per ruajtjen e pronave, u veprua me grusht te hekurt si ne rastin e Bshkim Bajraktarit qe u shkarkua nga detyra, veprim qe u pasua nga nje diskriminim i eger qe perfundoi me emrimin e tij ne nje mikro xhami jashte qytetit. Pasi KMSHi lau hasapet

me rebelin Bjraktari ato u trimuruan dhe filluan t, I hedhin ne treg pronat e muslimaneve sikur t, I kishin te babes. Rasti i fundit ishte shitja e nje siperfaqeje shume te madhe truadhi nje biznesmeni me nje cmim shume qesharak ne krahasim me ate te tregut, duke demtuar keshtu shume rende interesat e muslimaneve ne te gjithë Shqiperine, gje qe solli ne indinjate te papare ne rrallet e tyre. Ne kete indinjate perfshihet edhe greva e urise qe po bejne besimtaret e xhematit te xhamise se Tabakeve, te cilet kane vendosur te vetsakrifikohen per te mrojtur pronat e vakufit. veprim ky ne antiteze me ato qe po i tkurrin pronat e muslimaneve duke i cuar shume shpejt drej zhdukjes, sepse sot eshte thuaje e pamundur qe dikush te dhuroje toke dhe troje per vakufin. Ne, si shoqata qe po prononcohem, sot mbeshtesim pa rezerva greven e urise te vellezerve tane muslimane te xhamise se tabakeve dhe te xhemateve te tjera te xhamive te Tiranës, te cilet me petitionet e tyre, kane kerkuar anulimin e kesaj kontratoje te turpshme qe u sjell aq dem muslimaneve ne te gjithë ShqiperineAjo qe eshte e rendesishme ne deklaraten tone, eshte se ne kerkojme ne menyre te prere qe ato klane dhe ato persona qe jane perfshire ne keto

afere te rrezikshme per fatin e pronave te muslimaneve, te vihen para pergjegjesise ligjore dhe fetare, ku pjesen e luanit ne kete pergjegjesi ta kene ato qe drejtojne administrimin e pronave te vakufit dhe vecanarisht ato qe vendosin firmen vendimtare qe i hap rruge ketij batakcilleku. Shoqatat muslimane i kujtojne sot KMSH se pas kesaj deklarate, ato do te pershikallojne shume ashper qendrimin e tyre kunder atyre, qe duke abuzuar me karriken ku jane ulur, po i neperkembin interesat e muslimaneve duke luajtur si gjithmone rolin e grevthyesit kunder besimtarve muslimane ne ShqiperiDuke perfunduar kete deklarate, shoqatat muslimane te SHkodres kerkojne anulimin e kontrates se shitjes se truallit prane bustit te Azem Hajdarit qe ka realizuar ditet e fundit KMSH. SHOQATA BAMIRESE ISLAME SHKODER SHOQATA E INTELEKTUALEVE SHQIPTAR KULTURA ISLAME DEGA SHKODER. FORUMI MUSLIMAN SHQIPTAR DEGA SHKODER KLUBI KULTUROR DRITA SHKODER SHKODER ME, 5 MAJ 2007

ISLAMI RREZIK, APO ISLAMI NE RREZIK?!



Fanatiket shqiptare te versionit me te shemtuar 'falacian' te islamofobise pas botimit te pamfletit te Orianes 'Milef e Krenari' zune te ferkonin duart me nje gezim te papermbajtur dhe te kercenonin se per hakmarrje ndaj akteve terroriste te 11 shtatorit 2001 ne Nju Jork e ne Uashington, vete presidenti SHBA, Xhorxh W. Bush, do te vihej ne krye te kryqezates me te madhe ne histori per shkaterrimin e islamizmit ne te gjithë boten. Ata i varen turinjte me pakenaqesi kur Presidenti i Amerikes i shqiptoi fjalet e mesiperme ne nentor te vitit 2003, gjate nje fjaltimi perpara 'Fondacionit Kombetar per Demokraci'

Disa nga fanatiket e islamofobise ne Shqiperi e humben aq shume arsye sa filluan te cirreshin : ja cna bene myslimanet qe nuk kthehen ne te krishtere, tani Presidenti amerikan po e quan Shqiperine vend islamik(!). Kete marrezi e perseriten edhe ata qe ne shkurt te vitit 2006 mbeten te shushatur kur degjuan qe ministri i jashtem i Spanjes e quajti Shqiperine vend ku 80% e Shqiperise eshte myslimane.

Tani kercenimi islamik eshte mitizar edhe me shume dhe po paraqitet s i vetmi rrezik me te cilin duhet te perballtet bota, duke perdorur te gjitha mjetet, perfshire ketu edhe perdorimin e armeve berthamore. Studiuesi islamofob amerikan, Sem Harris, e quan 'Islamin radikal' edhe me te keq dhe me te rrezikshem se vete terrorizmin dhe keshillon: 'E vetmja gje qe ka gjasa te siguroje mbijetesen tone mund te jete qe ne te japim te paret goditjen berthamore.... do te kete nje numer te

madh viktimash qe nuk e merr dot me mend, dhjetra milion te pafajshem, por kjo mund te jete e vetmja menyre veprimi kur kemi parasysh se cfare besojne myslimanet'. Harris eshte nje nga ato qe mendojne se tashme ka filluar lufta e 4 Boterore (e Treta quhet Lufta e Ftohte) dhe permend edhe nje baskmendimtar tjetër, Kohen, qe qenka shprehur se: 'Armiku ne kete lufte nuk eshte terrorizmi, por Islami militant'

'Me 20 shtator 2001, dyzet neokonservatore i derguan nje leter te hapur Bushit qe ta rrezonte Sadamin dhe te shkaterronte Hezbollahun, duke shtuar si mase plotesuese qe ai te mesynte edhe Sirine dhe Iranin ne qofte se ato nuk i shkepusin marrdheniet me Hezbollahun. Nje lob i tille ishte pjese e rrjedhes ne Uashington dhe nuk do ti jepnim rendesi ne qofte se Xhorxh Bush nuk do ti kishte kushtuar vemendje. Termi qe u perdor per misionin qe i propozojte Bushit ishte shkaterrim krijues. Komentatore serioze si Norman Podorec kerkonin fitoren ne luften e 4 boterore kunder islamit militant. Ata me me pak seriozitet, por jo me ndikim me te vogel, si Ricard Perle, mendonin se nuk do te ishte ide e keqe te pushtohej Meka bashke me fushat naftembajtese, sa per te provuar se kesh i kishte muskujt me te forte'.

Keto i ka shkruar gazetari dhe botuesi idian mysliman M. J Akbar, ish-depute ne parlamentin e Indise. Norman Podorec eshte nje nga figurat e rendesishme te lobit sionist ne SHBA.

Si Harris, Koheni, Podoreci, Pajpsi, Perli mendojne shume politikane, intelektuale, klerike e njerez te tjere ne bote, pavaresisht se nuk e thone troc. Si Harris, Pajpsi e Koheni, Perli kemi edhe ne Shqiperi e midis Shqiptareve: Ismail Kadarene, Pirro Mishen, Maks Velon, Skender Shkupin, Fahri Balliun, Kastriot Myftarajn e plot katolikocentriste janullatiste etj

Sapo vune re qe sistemi komunist ne Europen Lindore po shkonte drejt shembjes se pashmangshme strategjet politike, perpunuesit e psikologjise publike dhe shpelaesit e trurit te jerezve ne Perendim iu vune punes te gjenin armikun e ri per t'i mbajtur ngritur tensionet ne bote. Me 11 mars 1990 ne gazeten e madhe 'Nju Jork Tajms' shkruhej: 'Tani qe e vume ne gjume komunizmin duhet te shpikim nje rrezik tjetër te tmerrshem. '. Ndersa studiuesi

Stjuart Sim ne vitin 2004 verente se: 'Fondamentalizmi ka zevendesuar gogolin e komunizmit per te trembur ndergjegjen perendimore'.

Ne vitin 1996 Fred Hollidei i qartesonte dhe i paralajmeronte njerezit: Mbasi mori fund Lufta e Ftohte duket se rivalitete te tjera do ta zevendesojne ate dhe njeri prej tyre eshte ai midis Islamit dhe Perendimit'. Kur Hollidei shprehej keshtu ishte ende heret per te perceptuar dhe kuptuar ne permasa te plota rrjedhojat e tezes se Samuel Hantingtonit mbi perplasjen e qyteeterimeve te paraqitur ne vitin 1993. Ne vitin 1996 midis Perendimit dhe Isalmit shihej ende ne kuader te atij ballafaqimi te meparshem midis Perendimit dhe Lindjes, ose si nje aspekt i ballafaqimit te Perendimit me te gjithë. Duhej te ka;lonin edhe pese vjete te tjere per te degjuar thirrjen 'Te bashkohemi te gjithë kunder rrezikut islamik' qe u leshua menjehere pas ngjarjeve tragjike qe sollen aktet terroriste me 11 shtator 2001 kunder Kullave Binjake te Qendres Boterore Te Tregtise ne Nju Jork dhe Pentagonit afer Uashingtonit. Qysh nga ai rast terminologjia 'te zhdukim rrezikun islamik' eshte perdorur si nje formuke e shenjte dhe e padiskutueshme ne Perendim dhe mbeshtetesit e politikës se SHBA kudo ne bote. Kjo formule eshte keqperdorur per te rritur shkallen e islamofobise qe ka infektuar keq edhe shume shqiptare dhe qe pergatit kushte per zhvillime te rrezikshme per Shqiperine.

**Marre nga libri
"Perballjet me Islamofobine"
Me autor Abdi Baleten**

Kontakt me "BESIMTARI"
www.gazetabesimtari.com
Tel: 0225 18 73
Fax: 0225 18 73
Cel: 0692234298

**Faqosja:
Gazjon Rusi**